

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-60/020	Data: Datum: 03.03.2020	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Prokurimit për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Sanimi i gjendjes të kabullit optik për kamerat e sigurisë në qytetin e Istogut" me numër të prokurimit 633-20-523-136 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Sanimi i gjendjes të kabullit optik për kamerat e sigurisë në qytetin e Istogut" me numër të prokurimit 633-20-523-136 dhe në komision caktohen:
 1. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i lartë për Infrastrukturë Rrugore Kryesues i komisionit;
 2. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar dhe
 3. **Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar.
2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Sanimi i gjendjes të kabullit optik për kamerat e sigurisë në qytetin e Istogut" si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Prokurimi.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të Vendimit të njoftohet: Komisioni, Prokurimi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-61/020	Data: Datum: 03.03.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-7774 të datës 27.02.2020 të parashtruar nga z.Faik Alushaj nga Istogu, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënes në dializë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-7774 të datës 27.02.2020 e parashtruar nga z.Faik Alushaj për përkrahje me karburant për dërgimin e nënes për dializë dhe i lejohet 57 litra karburant për muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që z.Faik Alushaj të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Faik Alushaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-7774 të datës 27.02.2020 , me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i nënes (Emine),për dializë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Emine Alushaj është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për dializë .

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për dializë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmenduren më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Faik Alushaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ


**Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA**

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-62/020	Data: Datum: 03.03.2020	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Prokurimit për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: “Evitimi i dëmeve nga fatkeqësia natyrore për objektet shkollore në komunën e Istogut” Loto 1- Shkolla Bajram Curri-Istog, Loto 2 -Shkolla Bajram Curri-Muzhevinë, Loto 3-Shkolla Hysni Zajmi-Vrellë, Loto 4- Shkolla Zymer Zeka-Kaliqan, Loto 5-Gjimnazi Haxhi Zeka-Istog, me numër të prokurimit 633-20-422-521 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Evitimi i dëmeve nga fatkeqësia natyrore për objektet shkollore në komunën e Istogut” Loto 1- Shkolla Bajram Curri-Istog, Loto 2 -Shkolla Bajram Curri-Muzhevinë, Loto 3-Shkolla Hysni Zajmi-Vrellë, Loto 4- Shkolla Zymer Zeka-Kaliqan, Loto 5-Gjimnazi Haxhi Zeka-Istog, me numër të prokurimit 633-20-422-521 dhe në komision caktohen:
 1. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i lartë për Infrastrukturë Rrugore Kryesues i komisionit;
 2. **Shkelqim Blakaj**, Sekretar i SHFMU “Hysni Zajmi në Vrellë, anëtar dhe
 3. **Gëzim Ademaj**, Zyrtar i Lartë i Prokurimit, anëtar.
2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: “Evitimi i dëmeve nga fatkeqësia natyrore për objektet shkollore në komunën e Istogut” Loto 1- Shkolla Bajram Curri-Istog, Loto 2 -Shkolla Bajram Curri-Muzhevinë, Loto 3-Shkolla Hysni Zajmi-Vrellë, Loto 4- Shkolla Zymer Zeka-Kaliqan, Loto 5-Gjimnazi Haxhi Zeka-Istog, si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Prokurimi.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të Vendimit të njoftohet: Komisioni, Prokurimi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.63/020	Data: 03.03.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullore Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, me lajmërimin nga Menaxheri i Personelit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të nëpunës civil Sanije Mavraj, titulli i postit: Udhëheqës i Sektorit për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, nxjerr:

V E N D I M

1. **KOMPENZOHE**T: nëpunësja civile **Sanije Mavraj**: titulli i postit: Udhëheqës i Sektorit për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete në Drejtorinë për Administratë Komunale, në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar, për shkak të pensionimit.
 2. Nëpunës civil të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **05.03.2020**.
 3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Administratë Komunale.
1. Zyrtari Financiar për paga meditje dhe kompenzime, obligohet të bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
 2. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar për paga meditje dhe kompenzime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Sanije Mavraj, Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar për paga meditje dhe kompenzime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.64/020	Data: 03.03.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullore Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, me lajmërimin nga Menaxheri i Personelit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të nëpunësit civil Sami Ferati, titulli i postit: Udhëheqës i Sektorit për Arsim, nxjerr:

V E N D I M

1. **KOMPENZOHET:** nëpunësi civile **Sami Ferati:** titulli i postit: Udhëheqës i Sektorit për Arsim në Drejtorinë për Arsim, në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar, për shkak të pensionimit.
2. Nëpunësit civil të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **30.03.2020**.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim.
 1. Zyrtari Financiar për paga meditje dhe kompensime, obligohet të bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
 2. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar për paga meditje dhe kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Sami Ferati, Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar për paga meditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.65/020	Data: 03.03.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullore Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, me lajmërimin nga Menaxheri i Personelit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të nëpunësit civil Daut Bujupaj, titulli i postit: Zyrtar për Emergjencë, nxjerr:

V E N D I M

1. **KOMPENZOHE**T: nëpunësi civile **Daut Bujupaj**, titulli i postit: Zyrtar për Emergjencë në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpetim, në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar, për shkak të pensionimit.
 2. Nëpunësit civil të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **17.03.2020**.
 3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpetim.
1. Zyrtari Financiar për paga meditare dhe kompensime, obligohet të bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
 2. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar për paga meditare dhe kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Daut Bujupaj, Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar për paga meditare dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.67/020	Data: 04.03.2020	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë për Arsim 05Nr.1/2020 të datës 08.01.2020, shqyrtoj kërkesën 05Nr.104/020 të datës 03.03.2020 të parashtruar nga e Drejtorisë për Arsim për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Serbeze Cakutaj, me titull të postit: Mësimdhënëse e Gjuhës Shqipe, SHFMU "Zymer Zeka" në Kaliqan, nxjerr:

V E N D I M

1. **KOMPENZOHE**T: mësimdhënësjë e Gjuhës Shqipe, Serbeze Cakutaj, titulli i postit: Mësimdhënëse e Gjuhës Shqipe, SHFMU "Zymer Zeka" në Kaliqan, në lartësi prej 3(tri)pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit.
2. Mësimdhënëses së lartpërmendur i përfundon shërbimi me 25.03.2020.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime në Drejtorinë për Arsim, obligohet që Serbeze Cakutaj, t'ia bëjë pagesën, e 3(tri)pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt te fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Serbeze Cakutaj, Drejtoria për Arsim, Zyrtari Financiar për Paga, Meditje dhe kompenzime dhe një kopje mbetet në arkivën e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-69/020	Data: Datum: 05.03.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 14 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria Komunale për Arsim, shqyrtoi kërkesën 05.Nr.016-8069 të datës 02.03.2020 të parashtruar nga Naxhije Gjocaj nga fsh. Tomoc, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e vajzës Hana Gjocaj në qëndren rabilituese në Klinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 05.Nr.016-8069 e datës 02.03.2020, e parashtruar nga Naxhije Gjocaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e vajzës Hana Gjocaj në rhabilitim në qëndren ditore në Klinë pasi që e njëjta është me autizëm dhe i lejohen nga 50 litra karburant në muaj dhe atë deri me 31.07.2020.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë Naxhije Gjocaj me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Naxhije Gjocaj, ka parashtruar kërkesën 05 Nr.016-8069 të datës 02.03.2020, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i vajzës së saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Hana është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj në qendren rhabilituese në Klinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për në Klinë për marrjen e terapisë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën me vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja Komunale për Arsim do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Naxhije Gjocaj, Drejtoria Komunale për Arsim, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-75/020	Data: Datum: 10.03.2020	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe Vendimin të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/07 të datës 11.03.2020, lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së corona virus COVID-19, me qëllim të marrjes së masave për parandalim e infeksionit në Komunën e Istogut, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komiteti Komunal për Reagime Emergjente për parandalimin e Infeksionit Corona Virus COVID-19 dhe në Komitet caktohen:

- 1.1. Muj Osmañaj, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Deme Qeta- Drejtor i Drejtorisë për Inspeksion, anëtar;
- 1.3. Hajrush Shoshi, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar;
- 1.4. Enver Rugova, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpetim;
- 1.5. Ymer Vuthaj, Drejtor i Qendresë, Kryesore të Mjekësisë Familjare, anëtar;
- 1.6. Ramadan Gashi, Përfaqësues i Stacionit Policor në Istog
- 1.7. Sylë Huli, Përfaqësues i Kryqit të Kuq.
- 1.8. Lulzim Blakaj, Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.
- 1.9. Hysni Maxharraj, Drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
- 2.0. Besart Dreshaj, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis.
- 2.1. Rasim Mahmutovic, Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.
- 2.2. Vesna Malikovic, Zyrtare për kthim të qendrueshëm.
- 2.3. Fazli Stollaj, Zyrtar për IT.

2. Komisioni ka për obligim që të menaxhoj procesin e parandalimit të corona virus COVIT-19, që secili në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore të ndërmerr masat e nevojshme për parandalim të shfaqjes përkatësisht përhapjes së infeksionit në Komunën e Istogut.

3. Komisioni obligohet të jetë i angazhuar 24 orë dhe të veproj në bazë të rrethanave dhe situatës së krijuar në terren.

4. Për cdo veprim Komisioni duhet ti njoftoj organet kompetente sipas ligjeve dhe akteve nenëligjore në fuqi.

5. Vendimi është përfundimtar dhe hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me kopje të Vendimit të njoftohen Komisioni, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01/Zyrtarishtë	Data: Datum: 14.03.2020	

Komiteti Komunal për Reagime Emergjente për parandalimin e infeksionit të COVID-19, duke u bazuar në vendimin e Qeverisë në detyrë nr: 01/19, si dhe në vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë me numër 239/IV/2020, për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjyese COVID-19, në territorin e Komunës së Istogut, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Ndahen mjetet financiare në shumë prej 5,000.00 €(5mij euro), mjete këto të cilat merren nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, në programin buxhetor: Shërbimet e Shëndetit Primar(74000), për sigurimin e gjërave ushqimore për të gjithë punëtorët shëndetësor dhe jo shëndetësor të cilët janë të angazhuar në luftimin dhe parandalimin e pandemisë Covid-19, si dhe nëvojat e tjera për mbarëvajtje të procesit.

Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, obligohet ti bartë shpenzimet, dhe për të njëjtën ti shfrytëzoj kontratat e lidhura ndërmjetë Komunës së Istogut dhe operatoreve ekonomik.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Operoret ekonomik, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-82/20	Data: Datum: 18.03.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 68.1, pika 1 dhe 3 e Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, Vendimin e QRK-së për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID-19 në Kosovë dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.Prot. 01/11 i datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, Kryetari i Komunës z. Haki Rugova më 16.03.2020 pas takimit me Ekipin Ndërsektorial për koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve preventive për parandalimin e COVID-19 në Komunën e Istogut merr këtë:

V E N D I M

1. Subjektet afariste-ushqimore dhe tregtare që kanë vetëm artikuj ushqimor që operojnë në territorin e Komunës së Istogut ju lejohet të veprojnë nga ora 8:00-20:00. Këtyre subjekteve ju lejohet vetëm ofrimi i shërbimeve për konsumatorë në lëvizje. Nuk lejohet shërbimi as konsumimi i shërbimeve dhe produkteve për konsumatorë në hapësirat e lokalit (as brenda e as në terrasa).
2. Obligohen drejtorët e drejtorive komunale të Istogut që të bëjnë reduktimin e stafit në kuadër të administratës së komunës. Përveç personelit shëndetësor (mjekët dhe infermierët), inspektorët komunal dhe zjarrfikësit të tjerët janë të liruar nga detyra deri në njoftimin nga eprorët e tyre si masë preventive ndaj infeksionit me virusin COVID-19.
 - a) Zyrtarët komunal që lirohen sipas këtij vendimi obligohen që në raste të domosdoshme, varësisht nga situata e krijuar të paraqiten në vendin e punës.
 - b) Orari i punës së administratës së komunës reduktohet dhe do të jetë nga ora 08:00 deri në 12:00.
3. Mosrespektimi i këtij Vendimi do të konsiderohet si shkelje e dispozitave ligjore dhe vendimeve përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës i cili do pasojë me zbatimin e masave ndëshkuese nga organet kompetente.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen drejtorët e drejtorive komunale si dhe zyra e personelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është i plotfuqishëm deri në vendimin tjetër.



Kryetari i Komunës,
HAKI RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-89/2020	Data: Datum: 27.03.2020	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të nenit 18, paragrafi 7 i Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 5 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar sipas konkursit 09 Nr.320-03/20 të datës 09.03.2020 nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin 09 Nr.320-03/20 të datës 09.03.2020, për pozitën, **Shofer në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi** në Istog dhe në të caktohen:

1. **Daut Kabashi**, Udhëheqës e Sektorit për Pylltari, kryesues i komisionit;
2. **Valbonë Kaligani**, Zyrtare e Lartë për Pemëtari, anëtare;
3. **Fjollë Berisha**, Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Mediave, anëtare;
4. **Abedin Neziraj**, Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm, anëtar;
5. **Fisnik Shoshi**, Zyrtar Ligjor, anëtar.

2. Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën, **Shofer në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi**, në pajtim me procedurat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftojnë udhëheqësin e personalit për procedim të mëtejshëm.

3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, zyra e personalit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdesen anëtarët e komisionit.

Me kopje të këtij Vendimi do të njoftohen: anëtarët e komisionit, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës,
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-90/2020	Data: Datum: 30.03.2020	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Drejtorisë për Shërbimeve Publike për formimin e komisionit për pranimin e punëve lidhur me *“ndërtimin e dy shtëpizave të drurit për komunitetin katolik për nevoja të besimtarëve katolik të kishës së Gurakocit dhe Zllakuqanit”* nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për pranimin e punëve në *“ndërtimin e dy shtëpizave të drurit për komunitetin katolik për nevoja të besimtarëve katolik të kishës së Gurakocit dhe Zllakuqanit”* dhe në të caktohen:

1. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë, kryesues i komisionit;
2. **Blerim Bujupi**, Zyrtar për ndërtimtari , anëtar;
3. **Jozef Frrokaj**, përfaqësues i komunitetit katolik, anëtar.

2. Komisioni i lartcekur ka për obligim që të hartojë procesverbal në lidhje me pranimin e punëve në *“ndërtimin e dy shtëpizave të drurit për komunitetin katolik për nevoja të besimtarëve katolik të kishës së Gurakocit dhe Zllakuqanit ”* si dhe do t’i kryejë punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës,
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-91/2020	Data: Datum: 30.03.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), në kuadër të aktivitetit të prokurimit me qëllim të caktimit të Menaxherit për zbatimin e kontratës **“Rregullimi i hapësirës dhe infrastrukturës rreth palestrës sportive”** me numër të prokurimit 633-19-3752-5-2-1/C 315 dhe numër të brendshëm 633/019/035/521, nxjerr:

V E N D I M

1. Caktohet Menaxher i projektit, **Jashar Blakaj**, Drejtor i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi për zbatimin e kontratës **“Rregullimi i hapësirës dhe infrastrukturës rreth palestrës sportive ”** me numër të prokurimit 633-19-3752-5-2-1/C 315 dhe numër të brendshëm 633/019/035/521.
2. I lartpërmenduri do të jetë menaxher për zbatimin e kontratës të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi sipas projekti detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së këtij aktiviteti; do të njoftojë Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e këtij aktiviteti (kontratës) së cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së aktiviteteve në fjalë si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij kujdeset: Jashar Blakaj, Drejtor i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi - Menaxher i projektit.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Jashar Blakaj, Drejtor i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës,
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-92/2020	Data: Datum: 31.03.2020	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.20/1012 për punë vullnetare të nëpunësve civil pas pensionimit, shqyrtoi kërkesën 05 Nr.111/20 të datës 31.03.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Arsim për lejin e punës vullnetare pas pensionimit për Nezir Osmanaj i cili ka kryer detyrat në pozitën, Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa ,nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 05 Nr.111/20 të datës 31.03.2020 e parashtruar nga Drejtoria për Arsim për lejin e punës vullnetare pas pensionimit për Nezir Osmanaj i cili ka kryer detyrat në pozitën, Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa.
2. Për nevojat e institucionit personit të lartcekur i lejohet t'i vazhdojë t'i kryej detyrat me të cilat ka qenë i ngarkuar në pozitën e Zyrtarit të Lartë për Buxhet dhe Financa deri sa të përfundojnë procedurat e rekrutimit për pozitën përkatëse të cilat janë në procedim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdesen Drejtoria për Arsim dhe Udhëheqësi i Personelit.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendim do të njoftohen: Nezir Osmanaj, Udhëheqësi i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës,
Haki RUGOVA

